



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO		
KOMUNA E PODUJEVËS / OPSTINA PODUJEVO / MUNICIPALITY OF PODUJEVA		
DIREKTORIA E ADMINISTRATËS - UPRAVA ADMINISTRACIJE		
Dërguar më Dostavljeno	13/09/2023	
Njesi.org. Org. led.	Nr. Br.	Shtojcë - Prilog
02-046/09-	0068422	123
PODUJEVË - PODUJEVO		



Komuna e Podujevës  
Republika e Kosovës

Republika e Kroacisë  
Qyteti Grubišno Polje

**QYTETI GRUBIŠNO POLJE**, Republika e Kroacisë, Sheshi bana Josipa Jelačića 1,43290  
Grubišno Polje, përfaqësuar nga kryetari Zlatko Maderuh

**KOMUNA E PODUJEVËS**, Republika e Kosovës, rruga "Nuhi Gashi", 11000, Fahu Postal,  
Podujevë, përfaqësuar nga Kryetari Shpejtim Bulliqi

(më tej; palët në Marrëveshje)

Konkluduan këtë;

## MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

### DHE VENDOSJEN E MARRËDHËNIEVE MIQËSORE NË MES QYTETIT GRUBIŠNO POLJE DHE KOMUNËS SË PODUJEVËS

#### I

Me qëllim të zhvillimit të miqësisë ndërmjet qytetit Grubišno Polje dhe Komunës së Podujevës, bazuar në mirëkuptimin dhe besimin e ndërsjellë, palët nënshkruajnë këtë Marrëveshje për bashkëpunim dhe vendosjen e marrëdhënieve miqësore (në tekstin e mëtejshëm; marrëveshja) për të mirën e qytetarëve të qytetit Grubišno Polje dhe Komunës së Podujevës dhe në emër të inkurajimit të zhvillimit të atyre komuniteteve lokale. Bashkëpunimi bazohet në fushën e barazisë, respektit reciprok dhe përfitimit reciprok.

#### II

Me këtë Marrëveshje përcaktohet përmbajtja dhe format e bashkëpunimit ndërmjet Qytetit Grubišno Polje dhe komunës së Podujevës, i cili do të bazohet në partneritet dhe respekt të ndërsjellë. Palët në marrëveshje do të mbështesin reciprokisht zhvillimin e marrëdhënieve miqësore në të ardhmen, duke inkurajuar bashkëpunimin në të gjitha fushat e rëndësishme për

qytetarët e Grubišno Polje dhe Komunës së Podujevës dhe në këtë mënyrë do të kontribuojnë në përparimin dhe mirëqenien e tyre reciproke.

Bashkëpunimi do të bazohet në identifikimin dhe zbatimin e projekteve konkrete në fushat e më poshtme:

### **BUJQËSIA**

Në kuadër të kompetencave të tyre Qyteti Grubišno Polje dhe Komuna e Podujevës do të përpiqen të njihen mes veti për programet e tyre bujqësore, të shkëmbejnë përvojën dhe njohuritë e fituara, përmes prezantimeve dhe ekspozitave, të krijojnë projekte të përbashkëta, të gjitha me synim për të përmirësuar bujqësinë si përcaktues bazë të zhvillimit.

### **KULTURA**

Përmes shkëmbimit të ngjarjeve kulturore e krijimit dhe veprimit të përbashkët në atë fushë Qyteti Grubišno Polje dhe Komuna e Podujevës do të pasurojnë jetën kulturore të qytetarëve të tyre.

### **ARSIMI**

Bashkëpunimi në fushën e arsimit do të arrihet përmes shkëmbimit të njohurive dhe përvetësimit të njohurive të reja përmes bashkëpunimit të institucioneve arsimore me qëllim të përmirësimit të arsimit, përmes formave të ndryshme të programeve dhe aktiviteteve si organizimi i ligjëratave, konferencave, punëtorive dhe programeve arsimore.

### **SPORTI**

Organizimi i takimeve sportive nëpërmjet shoqatave sportive dhe klubeve amatore do të zhvillojë shpirtin sportiv dhe do të forcojë bashkëpunimin.

### **FUSHA TË TJERA BASHKËPUNIMI**

Bashkëpunimi përfshinë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës në fushën e energjisë, në fushën e aplikimit të projekteve sipas fondeve të Bashkimit Evropian, shkëmbimin e përvojës në udhëheqjen dhe strategjinë e menaxhimit në vetëqeverisjen lokale, prezantimin e mundësive turistike, dhe shkëmbimin në të gjitha fushat tjera të jetës shoqërore me interes të përbashkët, brenda fushës së vetëqeverisjes dhe në përputhje me ligjet kombëtare të palëve sipas kësaj Marrëveshjeje.

## **III**

Nënshkruesit e kësaj Marrëveshjeje do të mbajnë bashkëpunim të ndërsjellë përmes organeve të tyre përfaqësuese, bartësve të pushtetit ekzekutiv, bashkësive turistike, institucioneve, shoqatave të qytetarëve, subjekteve afariste dhe institucioneve tjetra me interes të përbashkët.

## **IV**

Kjo Marrëveshje është lidhur për një periudhë të pacaktuar, ku secila palë ka të drejtë ta anulojë Marrëveshjen nëse nuk është e kënaqur me zbatimin e saj, duke njoftuar palën tjetër me shkrim. Në këtë rast, brenda tre muajve nga njoftimi me shkrim për përfundimin, Marrëveshja do të pushoj së qeni e vlefshme.

## **V**

Kjo Marrëveshje bëhet e vlefshme nga momenti i nënshkrimit.

Kjo marrëveshje është hartuar në katër (4) kopje identike, secila në gjuhën kroate dhe shqipe, nga të cilat dy (2) i përkasin secilës palë në secilën nga gjuhët.

Në Grubišno Polje / Podujevë 12.9.2023.

**Për Komunën e Podujevës**

**Kryetari**

**Shpejtim Bulliqi**



**Për Qytetin e Grubišno Polje**

**Kryetari**

**Zlatko Maderuh**





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13, 58 shkronja f) dhe 62.2 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale, nr.03/L-040, nenet 16, 61 paragrafi 1.6 dhe nenin 64 paragrafi 3 të Statutit të Komunës nr.prot. 01-020/01-0050862/18, Kryetari i Komunës së Podujevës, merr:

### V E N D I M PËR EMËRIMIN E DREJTORIT/SHËS TË DREJTORISË SË BUJQËSISË PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

#### Neni 1

znj.**Lirie Hoti**, me kualifikim Bachelor Gjuhë Angleze, dhe Master në Fakultetin Juridik-Divizioni Civil, nga fshati Bradash-Komuna e Podujevës, emërohet;

➤ **Drejtoreshë e Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural**

#### Neni 2


E përmendura në funksionin e cekur emërohet në kohëzgjatje të mandatit të Kryetarit të Komunës, përveç nëse me vendim të veçantë vendoset ndryshe nga Kryetari i Komunës.

#### Neni 3

Vendimi hyn ditën e nënshkrimit.

I dërgohet:  
Të emëruarës  
Zyrës së personelit  
QSHQ / Arkivit

Nr.Prot: 02-101/03-0068776/23  
Podujevë, datë: 14.09.2023





**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## **KRYETARI I KOMUNËS**

Bazuar në neni 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L – 040 dhe nenin 16 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862/18, merr:

### **VENDIM**

#### **Neni 1**

Ngritet komisioni për largimin/zhvendosjen e auto pjesëve të cilat janë jashtë përdorimit të automjeteve zyrtare nga hapësira e oborrit të Komunës, në këtë përbërje:

Mirsim Hodolli, kryesues  
Sami Pajaziti, anëtar  
Herolind Statovci, anëtar

#### **Neni 2**

Largimi/zhvendosja e auto pjesëve të automjeteve zyrtare në një lokacion tjetër, i caktuar nga ana e komisionit, bëhet me qëllim të lirimit të hapësirës së oborrit të Komunës.

#### **Neni 3**

Komisioni për punën e kryer informon Zyrën e Kryetarit përmes Drejtorit të Drejtorisë së Administratës.

#### **Neni 4**

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*U dërgohet:*  
Drejtoria e Administratës  
Anëtarëve të Komisionit  
QSHQ/Arkivit

Nr.prot. 02-020/04-007049/23  
Podujevë, datë: 21.09.2023

**Kryetari i Komunës**  
**Shpejtim Bulliqi**



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



## **KRYETARI I KOMUNËS**

Bazuar në nenet 13 dhe 58.b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040, Ligjin nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal dhe nenet 16 dhe 61 parag.1.2 të Statutit të Komunës, nr. 01-020/01-0050862/18, merr:

### **V E N D I M**

#### **Neni 1**

Për tërheqjen e mjeteve monetare nga E-Kioskat e Komunës së Podujevës, ngritet komisioni në përbërje:

Arianit Shaqiri, udhëheqës i Gjendjes Civile	kryesues
Rrahim Berisha, zyrtar për teknologji informative	anëtar
Maliqe Arifi, zyrtare për kadastrë dhe gjeodezi	anëtare

#### **Neni 2**

Tërheqja e mjeteve monetare nga të gjitha E-Kioskat e Komunës bëhet varësisht nevojave të paraqitura për tërheqjen e tyre.

#### **Neni 3**

Mjetet monetare pas çdo tërheqjeje i dorëzohen arkatarit të Komunës.

#### **Neni 4**

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*Vendimi u dërgohet:  
Anëtarëve të Komisionit  
Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave  
QSHQ/Arkivit*

**Nr. prot.02-020/04-0070159/23**  
**Podujevë, datë:21.09.2023**





**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës      Opština Podujevo      Municipality of Podujeva

## KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 11, 58 shkronjat b) dhe g) të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr. 03/L-040 dhe nenet 14, 61 paragrafët 1.2) 1.7) të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862/18, jep këtë :

### AUTORIZIM

#### I.

**Autorizohet z. Fatlum Osmani**, Drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave në Komunën e Podujevës, që në mungesë eventuale të Kryetarit të Komunës, të nënshkruaj dokumentacionin nga kompetenca dhe përgjegjësitë e Kryetarit të Komunës.

#### II.

Nënshkrimi i dokumentacionit sipas pikës I bëhet në koordinim dhe konsultim paraprak me Kryetarin e Komunës.

#### III.

Autorizimi i jepet Drejtorit të Drejtorisë së cekur, për arsye se Nënkryetarja e Komunës së Podujevës gjendet në pushim të lehonisë.

#### IV.

Autorizimi vlen nga data 25.09.2023 deri më 29.09.2023.

*Nga një kopje e Autorizimit i dërgohet:*

-Të autorizuarit

-QSHQ/Arkivës

Nr.prot. 02-016/01-0070564/23  
Podujevë, datë: 22.09.2023





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



## KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenin 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862 të datës 29 qershor 2018, nenin 11 paragrafi 2, ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 3, nenin 26 paragrafi 1 dhe paragrafët 3.1 dhe 3.3, të Rregullores komunale për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.por.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me Vendimin e Kryetarit të Komunës nr. 02-020/04-0054227/22 të datës 04.07.2022, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin nr.prot.02-020/04-0008957/23 të datës 01.02.2023 për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave individuale për ndarje të subvencione, lidhur me shqyrtimin e kërkesës nr.prot.06-400/04-0069097/23 të datës 15.09.2023, merr:

### V E N D I M PËR PËRKRAHJE FINANCIARE

#### Neni 1

**znj. Valbonë Isufi**, me vendbanim në fshatin Dumnicë e Epërme -Komuna e Podujevës, për shkak të gjendjes së rëndë shëndetësore dhe ekonomiko-sociale, dhe në pamundësi të mbulimit të shpenzimeve për trajtim mjekësor operimit (Operim i kushtueshëm) për shkak të problemit me shikim, i jepet ndihmë financiare në shumë 1000 €.

#### Neni 2

Mjetet financiare ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe të njëjtat bartet përmes bankës në llogarinë e znj.Valbonë Isufi.

#### Neni 3

Për zbatimin e vendimit e kujdesen Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave.

#### Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*U dërgohet:*

*Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale-DSHMS.*

*Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF.*

*QSHQ/Arkivit.*

*znj.Valbonë Isufi (njoftohet përmes DSHMS-së)*

Nr.Prot. 02-422/01-0071057/23  
Podujevë, datë, 26.09.23

Kryetari i Komunës  
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



## KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenin 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862 të datës 29 qershor 2018, nenin 11 paragrafi 2, ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 3, nenin 26 paragrafi 1 dhe paragrafët 3.1 dhe 3.3, të Rregullores komunale për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.por.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me Vendimin e Kryetarit të Komunës nr. 02-020/04-0054227/22 të datës 04.07.2022, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin nr.prot.02-020/04-0008957/23 të datës 01.02.2023 për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave individuale për ndarje të subvencione, lidhur me shqyrtimin e kërkesës nr.prot.06-400/04-0070581/23 të datës 22.09.2023, merr:

### V E N D I M PËR PËRKRAHJE FINANCIARE

#### Neni 1

**z. Arnes Glloboderi**, nga fshati Llugë-Komuna e Podujevës, për shkak të gjendjes së ekonomiko-sociale, në pamundësi të mbulimit të shpenzimeve për trajtim mjekësor të fëmiut të tij Aron Glloboderi, i lindur me probleme shëndetësore, i jepet ndihmë financiare në shumë 1,500 €.

#### Neni 2

Mjetet financiare ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe të njëjtat bartet përmes bankës në llogarinë e Arnes Glloboderit.

#### Neni 3

Për zbatimin e vendimit e kujdesen Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave.

#### Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*U dërgohet:*

*Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale-DSHMS.*

*Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF.*

*QSHQ/Arkivit.*

*z.Arnes Glloboderi (njoftohet përmes DSHMS-së)*

Nr.Prot. 02-422/01-0071056/23  
Podujevë, datë, 26.09.2023

Kryetari i Komunës  
Shpejtim Bulliqi

*Per Arnes*



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



## KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronja b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-02/01-0050862/18, nenet 8 dhe 22 të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.prot.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, Vendimin nr.prot.01-400/03-0084071/22, të datës 29.09.2022, Për Miratimin e Projektbuxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2023 dhe Parashikimet Buxhetore 2024-2025, në implementimin e projektit "Furnizimi dhe Montimi i Serave Bujqësore 300m<sup>2</sup>"- Vazhdim i projektit , në rekomandim të Komisionit Ad-Hoc të ngritur me vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0029845/23, të datës 28.04.2023, për Shqyrtimin edhe Vlerësimin e Kërkesave për Ndarje të Subvencioneve sipas Ftesës Publike nr.12-060/03-0052812/23, të datës 25.07.2023, Kryetari i Komunës, merr:

### V E N D I M

#### Neni 1

1. Lejohen mjete financiare për subvencionimin e 7 (shtatë) fermerëve përfitues të Komunës së Podujevës në vazhdimin e implementimit të projektit "Furnizimi dhe Montimi i Serave Bujqësore 300 m<sup>2</sup>".

2. Mbështetja e fermerëve do të bëhet sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara nga Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në Ftesën publike për aplikim në projektin "Furnizim dhe Montim i Serave Bujqësore 300m<sup>2</sup>"- vazhdim i implementimit të projektit, përkatësisht fermerët përfitues do të participojnë 30% të vlerës së projektit, kurse pjesa tjetër e projektit mbështetet nga Komuna.

#### Neni 2

Qëllim i realizimit të këtij projekti është promovimi dhe zhvillimi i bujqësisë në territorin e Komunës së Podujevës.

#### Neni 3

Lista e aplikuesve të përzgjedhur për implementimin e projektit sipas nenit 1 është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

#### Neni 4

Për zbatimin e Vendimit kujdeset Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në bashkëpunim me Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për mbështetje dhe ofrim të ndihmave nga kategoria e mjeteve buxhetore subvencione dhe transfere, i cili do të bëjë verifikimin, konstatimin dhe vlerësimin e përmbushjes së kushteve dhe kriterëve nga ana e fermerit/es si dhe çështjeve tjera të parapara sipas ftesës publike përkatëse.

#### Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr. prot 12-320/01-0071303/23  
Podujevë, datë 26.09.2023

